



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja k) dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 25 parag. 1.2 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, nr. 03/L-164 dhe neneve 16 dhe 56 shkronja b) të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, merr:

V E N D I M **PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TË** **VEÇANT TË BANIMIT PËR PERIU DHËN 2018 - 2020 NË KOMUNËN E** **PODUJEVËS**

Neni 1

Për hartimin e propozimit të Programit për banim në Komunën e Podujevës, për periudhën 2018 – 2020, ngritët Grupi punues në përbërje:

1. Doruntinë Sollova, kryesuese
2. Arbresha Bashota, anëtare
3. Ismet Rama, anëtar

Neni 2

Grupi punues, propozimin e Programit për banim e harton në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore, bazuar në burimet financiare dhe Vendimin e Kryetarit të Komunës për hartimin e Programit të veçantë të banimit, për periudhën 2018 – 2020 në Komunën e Podujevës, nr. 02-550/01-0034960/18 të datës 27.04.2018

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

I dërgohet
Anëtarëve të Grupit
Arkivit

Nr.02-020/04-0034949/18
Podujevë, 03 maj 2018

Kryetari i Komunës
Agim Veliu



